

**ENKELEJDA ALITE**

**NIPT L01606037A**

**Adresa: Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 0, Zyra 19, Tirane**

**Mob. +355 (0)67 2005022**

**e-mail: enkealite@yahoo.com;**

**Tiranë, më 26.08.2024**

**Lënda: Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë viti kalendarik 2023 për Partinë e Indipendenteve(Centriste) të Shqipërisë.**

**Për: Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve  
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.65, datë 28.06.2024, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2023 për 11(njëmbëdhjetë) Parti Politike, midis të cilave ishte dhe Partia Indipendenteve(Centriste) te Shqiperise.

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, më datë 06.08.2024, kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë e Indipendenteve(Centriste) te Shqiperise për fillimin e procedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me poste të letrave me kthim përgjigje, në adresën e selisë së partisë vënë në dispozicion nga KQZ-ja.

Por kjo mënyrë komunikimi rezultoi pa sukses, pasi ne morëm përgjigje ne lidhje me kete leter se **adresa e subjektit politik është e pamjaftueshme.**

Për këtë parti u përdorën gjithashtu dhe komunikimet që mundëm të merrnim nga ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si numra telefoni apo e-maile, nga kerkime ne internet por dhe kjo mënyrë nuk solli rezultat.


Ne besojmë se kemi bërë përpjekjet e duhura për të vendosur komunikimin zyrtar me kete parti por kjo qe e pamundur dhe për rrjedhim misioni i auditimit për Partinë e Indipendenteve (Centriste) te Shqiperise nuk u realizua.

Bashkangjitur dokumentacioni vërtetues: Letra e dërguar me postë dhe konfirmimi i shërbimit postar për dërgimin e kësaj letre me kthim përgjigje.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**Enkelejda Alite**  
**Auditues Ligjor**





Nr: 1001

DEFTESE 06/08/2024 11:34:26

PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE

Objekti Letra Letër  
KOD-BAR RR640197510AA  
Derguesi ENKELEJDA ALITE  
Marresi PARTIA E

INDIPENDENTEVE TE SHQIPERISE

Vend Mberritja TIRANA

Pesha 10 gr

LM RR645192960AA

Sherbime te vecanta 50  
LM ne postim 50

Tarifa Shtese 70

Tarifa Postare 120

Tarifa Totale

Nenshkrimi: Marjola Odobashi

inë, më 06.08.2024

## Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor

**Për: Partia Indipendentëve (Centriste) të Shqipërisë**  
**Adresa e selisë: Tiranë**

Me vendimin e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) nr.65, datë 28.06.2024 , jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfutuara dhe të shpenzuara nga Partia Indipendentëve (Centriste) të Shqipërisë gjatë vitit kalendarik 2023, të deklaruara në raportin financiar vjetor dhe në raportime të tjera financiare dorëzuar KQZ-së për këtë periudhë.

Sipas kontratës nr.2245 prot. datë 29.07.2024, me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit është: *"Kryerja e auditimit të detyrueshëm të fondeve të përfutuara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2023, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfutuara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendës, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre". Afati kufi i përfundimit të procesit të auditimit është data 29.08.2024.*


Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabël për të na bërë të disponueshëm dokumentacionin kontabël, rregjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Përgjigjen drejtojeni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

**Enkelejda Alite**  
**Auditues Ligjor**





OSTA SHQIPTARE sh.a.



22-SH.-

Vula e Zyrës Pran...

ARRJE NR .....



Ky lajmërim - marrje do të kthehet në adresën time si më poshtë:

Z. ENKELIJA ANTE  
Rr. Abdi Toptani  
Torre Dria, Kasti  
Zyng 18, Tirane

LP

E (CENTRIST)



Plotësohet nga dërguesi  
cili duhet të tregojë drejtimin  
: tij të plotë për kthimin  
: këtij lajmërimi  
Mod P6

Mod. E-10

**KTHEHET**

I PANJOHUR

LARGUAR

ADRESE E PAMIAFTUESHME

KA NDRYSHUAR ADRESE

OBJEKT I PA KERKUAR

REFUZUAR

ADRESE E PASAKTE

DATA E KTHIMIT